



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi “Zog I”, Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 849 Prot.

Tiranë, më 22.12.2016

V E N D I M

Nr. 161, datë 22/12/2016

“Për përfundimin e procesit të verifikimit në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 74, datë 28.07.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1,14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1211/1, datë 23.11.2016, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 74, datë 28.07.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Elbasan”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërej se:

Me Vendimin Nr. 24, datë 12.03.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civi, si dhe në lidhje me procesin e ristukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Elbasan”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar inspektimin, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, pranë Këshillit të Qarkut Elbasan. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 74, datë 28.07.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Elbasan” të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Këshilli i Qarkut Elbasan, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit, në mënyrë nominale, për secilin nëpunës të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, sipas parashikimeve të nenit 50, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe me Vendimin Nr. 171, datë 26.03.2014, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*, të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i riemërimit të çdo nëpunësi të DAMT-së dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).
3. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III, *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”* dhe ta administrojë atë në dosjen e personelit (dosjen individuale).
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 665 prot., datë 16.11.2016, *“Në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 74, datë 28.07.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka kërkuar nga institucioni informacion në lidhje me masat që janë marrë për zbatimin e këtij vendimi, dhe vënien në dispozicion të të gjithë praktikës shkresore që materializon zbatimin e tij, brenda një afati 10-ditor nga marrja dijeni.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Këshilli i Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 1211/1 prot., datë 23.11.2016, *“Kthim përgjigje shkresës tuaj”*, ka vënë në dijeni Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor bashkëngjitur shkresës së mësipërme, rezultoi se:

- Në lidhje me zbatimin e pikës 2 të vendimit dhe të rekomandimeve të Komisionerit në Raportin Përfundimtar të Inspektimit, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e emërimit pas ristrukturimit, në mënyrë nominale, për punonjësit e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në 6 raste:
 1. Me Urdhrin Nr. 68/4, datë 17.02.2015, *“Riemërim në detyrë, pas ristrukturimit të institucionit”*, punonjësi ***** është riemëruar në detyrën e Përgjegjës të ZAMT-së Peqin.

2. Me Urdhrin Nr. 68/5, datë 17.02.2015, “Riemërim në detyrë, pas ristrukturimit të institucionit”, punonjësi ***** është riemëruar në detyrën e Përgjegjës të ZAMT-së Librazhd.
3. Me Urdhrin Nr. 68/7, datë 17.02.2015, “Riemërim në detyrë, pas ristrukturimit të institucionit”, punonjësi ***** është riemëruar në detyrën e Specialistit të ZAMT-së Librazhd.
4. Me Urdhrin Nr. 68/6, datë 17.02.2015, “Riemërim në detyrë, pas ristrukturimit të institucionit”, punonjësi ***** është riemëruar në detyrën Specialist i ZAMT-së Elbasan.
5. Me Urdhrin Nr. 68/2, datë 17.02.2015, “Riemërim në detyrë, pas ristrukturimit të institucionit”, punonjësi ***** është riemëruar në detyrën e Përgjegjës të ZAMT-së Elbasan.
6. Me Urdhrin Nr. 68/3, datë 17.02.2015, “Riemërim në detyrë, pas ristrukturimit të institucionit”, punonjësi ***** është riemëruar në detyrën e Përgjegjës të ZAMT-së Gramsh.

Duke iu referuar Raportit Përfundimtar të Inspektimit, rezulton se në dokumentacionin e dërguar nga Këshilli i Qarkut Elbasan, mungon akti i riemërimit pas ristrukturimit për punonjësin *****. Nga komunikimi me njësinë përgjegjëse rezultoi se për punonjësin në fjalë kishte përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, si pasojë e plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë.

- Në lidhje me zbatimin e pikës 3, të vendimit dhe të rekomandimeve të Komisionerit në Raportin Përfundimtar të Inspektimit, njësia përgjegjëse ka njoftuar punonjësit për ndryshimet e ndodhura pas ristrukturimit dhe ka marrë mendimin e tyre me shkrim (në 31 raste) lidhur me pozicionin në të cilin janë transferuar.

Bazuar në dokumentacionin e administruar, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të inspektimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi Nr. 74, datë 28.07.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Elbasan”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 74, datë 28.07.2015, në institucionin, Këshilli i Qarkut Elbasan.
- 2.** Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 74, datë 28.07.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Elbasan”*.
- 3.** Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Këshilli i Qarkut Elbasan, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA